



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

I	Data	13.03.25	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
01	370/07-DESS	1		

KONTRATA PËR SHËRBIME

Komuna e Kaçanikut (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), i përfaqësuar nga **Izahir Kuka – u.d. Menaxher i prokurimit**; në njërën anë dhe

NHSH "LEONI - I", **Shkëmbim Dema B.I** (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), i përfaqësuar nga **Shkëmbim Dema** përfaqësues në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

“Shërbimet e byfësë në Administratën Komunale “

Kontratë njëvjeqare me numër Identifikues **KA652/25/03/236 (652-25-573-236)**.

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **“Shërbimet e byfësë në Administratën Komunale “**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me **17.03.2025** dhe përfundon më **16.03.2026**

Kontrata mund të ndërprehet edhe para datës së skadimit në rast të demolimit të objektit të komunes me paralajmërim prej së paku 10 ditë më heret.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **një vitë** nga data e nënshkrimit të kontratës

1.4 Vendi i **Komuna Kaçanik**

1.5 Incotermin i aplikueshëm do të jetë **DDP¹** (Detyra e Dërguar e Paguar).

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

PJESA II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

PJESA A						
Pesha sipas kategorive - 60%						
NR. I ART.	PËRSHKRIMI	NJËSIA MATËSE	SASIA	ÇMIMI PËR NJËSI ME TVSH €	ÇMIMI TOTAL ME TVSH €	VENDI I ORIGINËS
	Pije të nxehta					
1	Kafe makiato e vogël	copë	1	0.50	0.50	
#	Kafe makiato e madhe	copë	1	0.50	0.50	
#	Kafe Express e gjatë	copë	1	0.50	0.50	
#	Kafe Express e shkurtë	copë	1	0.50	0.50	
#	Kafe turke	copë	1	0.40	0.40	
#	Kafe kapuçino	copë	1	0.30	0.30	
#	Nes café	copë	1	0.50	0.50	
#	Qumësht me çokollad	copë	1	0.50	0.50	
#	Çaj i zi në gota te vogla 0.10 liter	copë	1	0.10	0.10	
#	Çaj të ndyshem në filtera	copë	1	0.40	0.40	
TOTALI PJESA A - PIJE TE NXEHTA					4.20	

PJESA B						
Pesha sipas kategorive - 40%						
NR. I ART.	PËRSHKRIMI	NJËSIA MATËSE	SASIA	ÇMIMI PËR NJËSI ME TVSH €	ÇMIMI TOTAL ME TVSH €	VENDI I ORIGINËS
	Pije të ftohta					
1	Pije në kanaqe 0.33 liter	copë	1	0.80	0.80	
2	Lëngje Frutash paketim qelqi 250ml	copë	1	0.80	0.80	
3	Ujë të gazuar 0.5 litër	copë	1	0.40	0.40	
4	Ujë të pagazuar 0.5 litër	copë	1	0.40	0.40	
#	Ujë të pagazuar me paketim qelqi 0.25 litër	copë	1	0.50	0.50	
#	Ujë të gazuar me paketim qelqi 0.25 litër	copë	1	0.50	0.50	
TOTALI PJESA B - PIJE TE FTOHTA					3.40	

TOTALI PJESA A - PIJE TE NXEHTA 60 poena	4.20
TOTALI PJESA B - PIJE TE FTOHTA 40 poena	3.40
Totali	7.60

Vlera e Partashikur e Çmimit është 9,980.00€

3.1 -OE NHSH "Leoni" në bazë të DT obligohet në emer të qerasë mujore për shfrytëzimin e hapsires në obj. e Adm. komunale ti paguaj 100.00€ në llog. e buxhetit të komunës më së largu gjer me 15 të muajit vijues.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

-Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë

- Pagesa bëhet pas raportit me shkrim nga ana e Menagjeri i Kontrates për shërbimet e kryera.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit. Të respektohet kodi i veshjes për shërbimet te hotilerisë.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të jet deri në kryerjen e shërbimit

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin **[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [të kryej ndonjë ose të gjitha punët]** brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **[shërbimeve]** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori

Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Kontrata mund të ndërprehet edhe para dates së skadimit në rast të demolimit të objektit të komunes me paralajmërim prej së paku 10 ditë më heret, dhe Autoriteti kontraktues nuk ka obligim të siguroj hapsirë tjetër për vazhdimin e veprimtarisë.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në gjykatën komunale në Kaçanik në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip] në tri origjinale, për Autoritetin Kontraktues(ZP dhe DUGJK), dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Shkëmbin Dema	Emri:	Izahir Kuka
Pozita:	Prohar	Pozita:	U.D. Menagjer i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	13.03.2025	Data:	13.03.2025
Vula:		Vula:	

Kryetari i Komunës
01 Nr. 370/01-5858
Kaçanik, 13.03.2025

Në bazë të nenit 8.1 pika g dhe 55.15 të Udhëzuesit operativ për prokurimin publik, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
PËR EMËRIMIN E MENAXHERIT TË PROJEKTIT

I

Me këtë vendim **Dardana Tafili Dauti** emërohen Menaxhere e projektit: **Shërbimet e byfesë në Administratën Komunale, me nr. të Kontratës 01NR. 370/01-5858 te datës 15.03.2025.**

II

Menaxheri i projektit do të jetë përgjegjës për menaxhimin e projektit të lartpërmendur, do të raportoj me shkrim Zyren e Prokurimit dhe Kryetarin e komunës mbi realizimin e shërbimeve.

III

Sipas këtij vendimi Menaxheri i projektit do të jenë të angazhuar në procesin e implementimit të projektit,

IV

Me këtë vendim të njoftohet: Menaxheri, Zyra e prokurimit dhe DAP



Kryetari i komunës
Besim Ilazi